

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detajet - Digjet sërish shtëpia e gazetarit Vudi Xhymshiti, ai ngre dyshime për lidhje me punën e tij, përmend figura të PDK dhe AAK
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919593/digjet-serish-shtepia-e-gazetarit-vudi-xhymshiti-ai-ngre-dyshime-per-lidhje-me-punen-e-tij-permend-figura-te-pdk-dhe-aak/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 06:10:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 06:03:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	840de44d090031aa8408e8c12bc2c36c16612bf92943ceaaab9b43fbcfbf09214
TEKSTI	d2f9d0c7593b5823f36764b7a094ed0c55fb786e93af4732f8492151388f68e0
PAMJA	490a897841f1f533b7044493d8e96501ffea139e56902a6b0349563357d7f687

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9862008e5c1bdd02c8cdc5c8877de6a47dd35df54deacec93e4a5893d7ac7607
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2fad39eb4a5630a03d13ec48550b069ca76ccbe736c7b94b7af60112a505f929
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9862008e5c1bdd02c8cdc5c8877de6a47dd35df54deacec93e4a5893d7ac7607>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ÇIM PEKA**
'Nuk e dija, nuk mjafton më'**FATMIR MEDIU**
Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiqit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

Digjet sërish shtëpia e gazetarit Vudi Xhymshiti, ai ngre dyshime për lidhje me punën e tij, përmend figura të PDK dhe AAK

08:03, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Gazetari Vudi Xhymshiti dhe shtëpia e prindërve të tij, e dëmtuar nga zjarri. Ai ngre dyshime se ngjarja mund të lidhet me punën e tij gazetareske, ndërsa autoritetet po hetojnë rastin.

Gazetari investigativ Vudi Xhymshiti, i njohur për qëndrimet e tij kritike ndaj figurave dhe grupeve politike të lidhura me PDK-në dhe AAK-në, ka njoftuar se shtëpia e prindërve të tij të ndjerë është përfshirë nga zjarri. Ai dyshon se ngjarja mund të lidhet me punën e tij gazetareske dhe kërkon hetim të plotë nga institucionet e Kosovës.

Shtëpia e familjes së gazetarit Vudi Xhymshiti në fshatin Livoç i Ulët të Gjilanit është përfshirë nga zjarri, duke shkaktuar dëme materiale. Ngjarja është raportuar në Policinë e Kosovës më 26 shtator 2026, ndërsa rrethanat dhe koha e saktë kur ka shpërthyer zjarri mbeten ende të paqarta.

Rasti ka marrë vëmendje të veçantë pas reagimit publik të gazetarit, i cili ka rikujtuar se e njëjta shtëpi ishte djegur edhe gjatë luftës në Kosovë, në vitin 1999, nga forcat serbe të regjimit të Sllubodan Millosheviqit, sipas dëshmisë së tij.

Xhymshiti ka ngritur dyshime se incidenti i fundit mund të jetë i lidhur me veprimtarinë e tij gazetareske dhe me kërcënimet e presionet publike që pretendon se ka përjetuar.

Xhymshiti: Nuk do të ndalem

Në reagimin e publikuar në Facebook, gazetari ka shprehur shqetësimin për sigurinë e tij dhe ka kërkuar që autoritetet të zbardhin rastin.

më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më

'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë Hysenit?

Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?

Berisha: Vlorë Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan

Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë

Ai ka deklaruar se nuk deshiron te akuzoje askend per shkaktimin e zjarrit pa pasur prova, por ka drejtuar akuza publike ndaj personave qe, sipas tij, kanë nxitur një klimë urrejtjeje dhe linçimi kundër tij.

Në reagimin e tij, Xhymshiti përmend drejtuesin e veteranëve të luftës, Hysni Gucati, figurën e PDK-së, Elmi Reçica, si dhe Dardan Krasniqin, të cilin e identifikon si përfaqësues të AAK-së.

Gazetari i akuzon këta persona për deklarata dhe veprime publike që, sipas tij, kanë kontribuar në shënjestrimin e tij për shkak të punës gazetareske.

Megjithatë, Xhymshiti nuk pretendon se ka prova që personat e përmendur kanë marrë pjesë në shkaktimin e zjarrit.

Duke bërë një krahasim me djegien e shtëpisë gjatë luftës në Kosovë, ai shprehet se përdorimi i frikës për të heshtur gazetarët përbën një kërcënim serioz.

Reagimin e përfundon duke deklaruar se nuk do të tërhiqet nga puna e tij dhe duke kërkuar përgjigje nga autoritetet kosovare.

Qëndrimet kritike ndaj PDK-së dhe AAK-së

Vudi Xhymshiti është themelues dhe kryeredaktor i Frontline Media Group. Në punën e tij gazetareske, ai ka trajtuar çështje të ndjeshme politike, përfshirë luftën në Kosovë, krimet e luftës, vrasjet politike dhe proceset gjyqësore në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Ai njihet gjithashtu për qëndrimet e tij kritike ndaj figurave dhe grupeve politike të lidhura me PDK-në dhe AAK-në, veçanërisht lidhur me përgjegjësinë për krimet e luftës dhe trajtimin e kundërshtarëve politikë.

Vetë Xhymshiti ka deklaruar më herët se nuk është i lidhur me asnjë parti politike dhe se qëndrimet e tij burojnë nga angazhimi profesional në gazetari.

Përplasjet e tij publike me përfaqësues politikë kanë përfshirë edhe mosmarrëveshje ligjore. Në qershor të këtij viti, Elmi Reçica njoftoi se kishte paraqitur padi civile dhe kallëzim penal kundër Xhymshitit, duke e akuzuar për deklarata të pavërteta dhe mesazhe kërcënuese ndaj tij dhe familjes së tij. Këto janë pretendime të Reçicës, jo përfundime gjyqësore.

Kërcënimet e mëparshme dhe incidenti në Hagë

Ngjarja e fundit vjen pas një periudhe përplasjesh dhe kërcënimesh të raportuara ndaj gazetarit.

Më 16 shtator, Frontline Media Group njoftoi se Xhymshiti dhe redaktori politik Michael Sheppard ishin përballur me shtyrje dhe kërcënime gjatë raportimit jashtë Dhomave të Specializuara në Hagë. Sipas organizatës, për shkak të situatës ishte nevojitur ndërhyrja e policisë holandeze.

Organizata ka raportuar gjithashtu se pas kësaj ngjarjeje në rrjetet sociale ishte publikuar një video që përmbante kërcënime ndaj Xhymshitit dhe ministres Donika Gërvalla.

Në deklaratën e saj të 27 shtatorit, Frontline Media Group bën të ditur se një person ishte ndaluar nga Policia për shkak të dyshimeve për kanosje lidhur me këtë video.

Organizata kërkon që këto ngjarje të shqyrtohen gjatë hetimeve për zjarren, por thekson se nuk ka prova që vërtetojnë një lidhje mes tyre.

Policia nis hetimet për zjarrvënien

Policia e Kosovës ka konfirmuar se më 26 shtator, rreth orës 15:45, ka pranuar informata për zjarrin në shtëpinë në Livoç të Ulët.

Sipas Policisë, nga zjarri janë shkaktuar dëme materiale në bodrumin e shtëpisë, ku ndodheshin një veturë, mjete pune dhe orendi shtëpiake.

Shtëpia ka qenë e pabanuar dhe nuk është përcaktuar ende koha e saktë kur ka ndodhur zjarri.

Në vendngjarje kanë dalë hetuesit policorë, njësitet e Krimteknikës Rajonale dhe eksperti për zjarre.

Pas konsultimit me Prokurorin e Shtetit, është iniciuar rast për hetime në drejtim të veprës penale të zjarrvënies. Shkaku i zjarrit mbetet i papërcaktuar.

Frontline Media Group kërkon hetimin e gjithë kronologjisë

Në reagimin e publikuar të dielën, më 27 shtator, Frontline Media Group ka kërkuar nga autoritetet kosovare që hetimi të mos kufizohet vetëm në dëmet materiale.

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

‘Mos kujtoni se ju kam vjedhur’/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen

‘Zullumi po e kap për fyti Ramën’, Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht

